

V E N D I M
Nr.35, datë 26.3.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Hilmi Dakli,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Hajredin Fuga,	Anëtar i	“““
Bardha Selenica,	Anëtare e	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 15.12.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.80/5 Akti që i përket:

K Ë R K U E S A:

ADNAN E AHMET DALLIU, të përfaqësuar nga avokat Sadedin Xhafa.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. DEGA E AGJENCISË KOMBËTARE TË PRIVATIZIMIT, PRANË BASHKISË TIRANË, në mungesë.
2. SEFER DUSHKU, përfaqësuar nga avokate Zana Hasko.
3. NDËRMARRJA RIPARIM SHËRBIMEVE NR.3 TIRANE (aktualisht e shkrirë)

O B J E K T I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1176, datë 1.10.1998 të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.131, datë 20.1.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Baza ligjore neni 38 i Ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi përfaqësuesit e palës kërkuese, të subjektit të interesuar Sefer Dushku dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesit Adnan e Ahmet Dalliu, pretendojnë se Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.1176, datë 1.10.1998 dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.131, datë 20.1.1998, kanë zbatuar gabim ligjin dhe nëpërmjet një procesi jo të rregullt ligjor u kanë cënuar të drejtën themelore të pronës.

Sipas nenit 38 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, çështja u shqyrtua fillimisht në kolegji e më pas në seancë gjyqësore, por para përfundimit të shqyrtimit të saj në këtë gjykatë, hyri në fuqi Ligji nr.8432, datë 14.12.1998 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, me të cilin u ndryshua ndërmjet të tjerave edhe neni 473 i Kodit të Procedurës Civile e si rrjedhojë ndaj vendimeve të formës së prerë, vendimeve të mospranimit të rekursit si dhe vendimeve të kolegjeve të Gjykatës së Lartë, palët kanë të drejtë të bëjnë rekurs në Kolegjet e Bashkuara. Sipas nenit 131 gërmës “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese bën gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Në këto kushte Gjykata Kushtetuese duhet ta nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit. Nga ana tjetër, të pranohet e kundërta dmth., që të vendosë Gjykata Kushtetuese për ankesën pa u ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, do të thotë të cënohen të drejtat e individit së pari, për të ushtruar

paraprkisht një mjet tjetër juridik siç është rekursi në Kolegjet e Bashkuara dhe së dyti, të shqyrtohet kjo ankesë jo më për të gjitha shkaqet e parashikuara në pikat “a”, “b”, “c”, etj., të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, siç vepron Gjykata e Lartë, por vetëm për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor që ka në kompetencë Gjykata Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE ;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 të Kushtetutës dhe nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës për mungesë juridiksioni.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 26.3.1999

Nr. 80/5 i regjistrimit themeltar

Nr.35 i vendimit